

# KLJUČ

CENTER ZA BOJ PROTI TRGOVANJU Z LJUDMI

**KURTHET E TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE- TI,  
GJITHASHTU, MUND TË JESH VIKTIMË.**

**NUK E BESON KËTË?**

**Botimi dhe shpërndarja u financua nga:  
Ministria e Brendshme e Republikës së  
Sllovenisë**

**Autorë: Shoqata Ključ– Qendra për Luftën  
kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Slloveni**



REPUBLIKA SLOVENIJA  
MINISTRSTVO ZA NOTRANJE ZADEVE



Ti le shtëpinë dhe dole jashtë vendit për të siguruar jetesën. Ju 'ndodh' të hasni dikë që është i gatshëm t'ju 'ndihmojë'. Ata ju thanë se do të merrni një vizë dhe një dokument udhëtimi. Falas. Ata njohin dikë që do t'ju dërgojë përtej kufirit, dhe një person tjetër që do të presë për ju në anën tjetër. Ata ju thanë të qëndroni të qetë nëse diçka shkon keq në kalimin e kufirit ose nëse ndodh që policia t'ju ndalojë. Sigurisht, do të duhet të flini diku. Ku? Ju nuk e dini. Ata thonë se ju do të punoni për miqtë e tyre dhe do të paguheni mirë. A është kjo punë në një bar? Në një sallon masazhesh? Në një apartament apo punëtori? Në një vend ndërtimi? Në një fermë? Ose në rrugë, ku duhet të lutesh për para apo të luash një instrument? Edhe pse nuk e kuptoni gjuhën, kjo nuk është problem; ju do të mësoni shpejt. Ata mbase, mund t'ju prezantojnë me bashkëshortin ose bashkëshortin tuaj të ardhshëm. A jeni duke shkuar në Slloveni?

- SI E DINI NËSE MUND T'I BESONI ATYRE?
- A KANË ATA SHUMË PARA, MIQ DHE MAKINA TË MIRA? NGA VIJNË PARATË E TYRE?
- KUSH JANË KËTA MIQ?
- PO JU LEJOJNE TË MBANI DOKUMENTET TUAJA ME VETE?
- PO JU LEJOJNË TË PËRDORNI TELEFONIN APO JU DUHET GJITHMONË TË MERRNI LEJE MË PARË.
- ËSHTË ÇDO GJË DUKE SHKUAR SIPAS ASAJ QË JU RATË DAKORT.
- A E DINI SE KUSH DO TË JETË PUNËDHËNËSI JUAJ DHE SA PARA JU DO TË FITONI?
- PO RRETH KONTRATËS SË PUNËSIMIT?
- A KENI TË DREJTË PËR DITË PUSHIMI, RAPORT MJEKËSOR, PUNË NË NJË MAKSIMUM PREJ 8 ORËSH NË DITË?
- A KENI TË DREJTËN TË ZGJIDHNI DHE TË THONI JO?
- A MUND TË NDRYSHOSH MËNDJE DHE TË LARGOHESH MENJËHERË?

**KËRKONI PËRGJIGJJET E KËTYRE PYETJEVE PËRPARA SE TË  
LARGOHENI**



**Trafikimi i qenieve njerëzore është i paligjshëm dhe nënkupton trajtimin e njerëzve si objekte. Në Slloveni, trafikimi i qenieve njerëzore është një vepër e rëndë penale.**

**Format e shfrytëzimit: prostitucioni i detyruar ose forma të tjera të abuzimit seksual, puna e detyruar, skllavëria, robëria, lypja, krimet e detyruara, martesat e detyruara ose partneritete të ngjashme dhe trafikimi i organeve, indeve dhe gjakut.**

**Trafikantët përdorin dhunën fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale. Përmes mashtrimit dhe shtrembërimit emocional, ata përfitojnë nga dobësia juaj kur keni nevojë për ndihmë, ose ju ofrojnë pagesa dhe përfitime nëse jepni pëlqimin për shfrytëzim.**

**NËSE E GJENI VETEN NË KËTË SITUATË MOS FAJSONI VETEN!**

**GJENI KURAJON TË KËRKONI NDIHMË!**

**MASAT PËR VETË-MBROJTE ...**

- **UDHËTIMI:** Tregojini të paktën një personi se kur, ku dhe me kë do të udhëtoni. Mbani me vete telefonin celular dhe mos harroni të regjistroni numra telefoni të rëndësishëm si: numrin e ambasadës së vendit tuaj, numrin e policisë apo organizatave të tjera që ofrojnë ndihmë. Më mirë do të ishte ti mbanit mend këto numra. Mos i jepni dokumentet tuaja të udhëtimit asnjë personi. Përveç kësaj, bëni disa fotokopje të dokumenteve të rëndësishme dhe i mbani ato në vende të ndryshme.
- **PUNËSIMI JASHTË VENDIT:** Jini të kujdesshëm në lidhje me burimin tuaj të informacionit rreth mundësisë së punësimit jashtë vendit. Gjeni detaje rreth punëdhënësit dhe kontrolloni informacionin në internet. Para se të filloni ndonjë punë, bëni një marrëveshje mbi kushtet e punës dhe kërkoni një kontratë, e cila duhet të kontrollohet nga një ekspert - mund të telefononi edhe Shoqatën Ključ.
- **MEDIA SOCIALE:** Mos harroni që mediat sociale lejojnë komunikimin anonim dhe se disa njerëz që mund të hasni në mediat sociale nuk tregojnë të vërtetën. Nëse planifikoni të takoni dikë personalisht, duhet të tregoheni shumë të kujdesshëm.
- **ÇËSHTJET E DASHURISË:** Në Slloveni dhe në mbarë botën, disa meshkuj në rrjetet kriminale, luajnë role vendimtare, pasi djemtë joshnin gratë dhe vajzat, vetëm për t'ua dorëzuar më vonë trafikuesve të qenieve njerëzore. Nëse një person ka shumë para dhe lidhje jashtë vendit, por nuk ka një punë të rregullt, mendoni rreth kësaj. Këta njerëz duken të këndshëm; ata mund ti blejnë një gruajë dhurata, ta marrin atë në udhëtime jashtë vendit, në mënyrë që të krijojnë lidhje emocionale dhe më pas tu besojnë atyre plotësisht. Kjo është mundësi e përkryer për ta, që ti marrin vajzat dhe ti shesin ato.

## **JU NEVOJITET NDIHMË?**

**Shoqata Ključ është e vetmja OJQ në Slloveni e cila është e specializuar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ne ofrojmë ndihmë falas dhe konkrete për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në të dyja rastet, kur të huajit janë subjekt i dhunës seksuale ose ndonjë forme tjetër abuzimi në Slloveni dhe kur qytetarë sllovenë bien viktima brenda ose jashtë vendit.**

## **Format e ndihmës:**



- këshillim telefonik,
- këshillim i drejtëpërdrejtë,
- ndihmë psiko-sociale,
- ndihmë juridike bazë,
- avokimi,
- informacion,
- ndihmë për tu larguar nga një situatë kërcënuese,
- ndihmë për të kontaktuar autoritetet e zbatimit të ligjit,
- ndihmë për marrjen e lejes për të banuar në Republikën e Sllovenisë,
- transferimi në një shtëpi të sigurt,
- përfshirja në një program (ri) integrimi,
- ndihmë për kthimin në vendin e origjinës.

**Shoqata Ključ- Qendra për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore  
P.P. 2722, 1110 Ljubljana, Slovenia**

**Free support lifeline: 080 17 22 (orari nga 9:00 deri në 13:00)**

**E-mail: [info@drustvo-kljuc.si](mailto:info@drustvo-kljuc.si) Website: [www.drustvo-kljuc.si](http://www.drustvo-kljuc.si)**

**FB: Društvo Ključ - center za boj proti trgovanju z ljudmi**

**Instagram: [drustvokljuc](https://www.instagram.com/drustvokljuc)**